



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudmana • Ombudsperson Institution**

Në pajtim me nenin 132 dhe nenin 133 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 32, paragrafi 2 të Ligjit, Nr. 05/L -019, për Avokatin e Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), shpall:

**KONKURS PUBLIK
për Marrëveshje me Shërbime të Veçanta**

Titulli i vendit të punës: Ekspert për teknologjinë informative (Një pozitë)
Numri i referencës: 01/2017/+MSHV
Niveli pagës: I Negociuar
Raporton: Drejtori Departamentit të Administratës
Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV)
Kohëzgjatja e emërimit: Tre muaj (me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj)
Orari i punës: I plotë
Vendi: Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Në koordinim me mbikëqyrësin:

- Identifikon, analizon, dhe vlerëson gjendjen në sistemin e Teknologjisë Informative (TI) të IAP, njëkohësisht propozon, këshillon dhe rekomandon menaxhmentin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) lidhur me nevojat e funksionimit dhe të zhvillimit të sektorit të TI të IAP, me qëllim të avancimit dhe të sigurimit afatgjatë të pajisjeve dhe sistemit të TI sipas kushteve dhe standardeve më të larta të sigurisë dhe të mirëmbajtjes të këtyre pajisjeve të TI;
- Përgjegjës për menaxhimin e pajisjeve dhe sistemeve të ndryshme të TI, për të siguruar ofrimin e shërbimeve të TI të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së IAP-it;
- Zhvillon softuerin e nevojshëm, rekomandon aplikacionet dhe platformat softwerike të rëndësishme të IAP-it, siguron ndihmën e duhur për njësitë organizative dhe zyrtarët e IAP-së në zhvillimin e programeve profesionale të nevojshme për përmbushjen e nevojave profesionale të IAP-it;
- Administrimin e përgjithshëm të “Domain Controller-it” në platformën Windows Server 2008, përfshirë, por pa u kufizuar në Implementimin e masave të sigurisë:
 - Menaxhimin në baza ditore të domain controllerit;
 - Zhvillimi, implementimi dhe monitorimi i politikave standarde për domain controller;
 - Databazën e të Dhënave – Centos;
 - Realizimin e Back-up ditor;
 - Monitorimi dhe raportimi lidhur me sigurinë e sistemit dhe shënimeve;
- Bën sigurimin e integritetit dhe sigurisë së të dhënave në databazën e IAP-it;
- Bën administrimin dhe intervenimin teknik për funksionalizimin dhe ri-funksionalizimin e pajisjeve kompjuterike (shtëpizave dhe laptopëve) si dhe të pajisjeve përcjellëse që janë në funksion të punës përmes kompjuterit (fotokopjeve, printerëve dhe skanerëve), të cilat janë në punë dhe shfrytëzim të punonjësve në zyrën në Prishtinë dhe në shtatë zyrtat regjionale të Kosovës (Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan dhe Graçanicë).



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale, të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkathtësitë e kërkua (*Kualifikimi, përvoja si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës*):

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike, të fituar përmes arsimimit universitar ose edhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri në fushën e tregut për pajisjet të TI;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe në formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale për fushën e TI;;
- Diplomë universitare në shkencat kompjuterike;
- Certifikata relevante profesionale MSCE në TIK që janë të lidhura me MS Family apo ngjashëm;
- Së paku 3 (tri) vjet përvojë në Menaxhimin e ICT (Information and Computer Technologies) ose në fusha të ngjashme të ICT-së.
- Njohja e gjuhës Angleze e preferuar, njohja e gjuhëve tjera të BE-së e mirëseardhur;

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Divizioni për Burime Njerëzore, zyra nr. 4, kati II, ndërtesa e ish-Bankës të Lubjanës, me nr. 21, Rr. “Migjeni”; 10000 Prishtinë, ose mund të shkarkohen në ueb-faqen www.ombudspersonkosovo.org

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **26 maj 2017 deri 2 qershor 2017**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit.